



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.772/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Afijete Sada - Gllogjani, Adnan Konushevcu anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Kaçanikut Valentina Murseli nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Kaçanikut, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.772/2021 i datës 04.11.2021, i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Kaçanikut Valentina Murseli nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Kaçanikut, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, me të cilën ka kërkuar korrigjimin e votave në fshatin Biçec Komuna e Kaçanikut.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 03.11.2021, ka pranuar apelin Anr.772/2021, i ushtruar nga Valentina Murseli Kandidat për Kuvend Komunal nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me të cilën pretendon se në ditën e zgjedhjeve pas numërimit të votave në fshatin Biçec (Kaçanik), është deklaruar nga komisionerët e parapaguar se unë kam 5 vota, të nesërmen pas konsultimit me votuesit që kanë deklaruar se kanë votuar dhe janë më shumë se 5 vota dhe të cilët janë të gatshëm të dëshmojnë se kanë votuar për mua edhe para Gjykatës. Pas bisedës me Kryetaren e AAK-së dega në Kaçanik dhe se ajo ka theksuar se në fshatin Biçec i ke gjithsej 13 vota dhe se ka qenë një keqkuptim nga ana e komisionerëve, por pas publikimit të formularëve të rezultateve unë kam parë që në fshatin Biçec janë gjithsej 5 vota.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Valentina Murseli, kërkon korrigjimin e votave në fshatin Biçec (Kaçanik), pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga Valentina Murseli Kandidat për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, më të cilin apel kërkon që ti korrigjohen votat në fshatin Biçec (Kaçanik) është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtuesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, i njëjti nuk ka ofruar saktë vendvotimet në të cilat pretendon se nuk i kanë dalë votat, por vetëm thekson në mënyrë të përgjithshme se ka mungesë të votave në fshatin Biçec (Kaçanik), edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë bartjes së votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete, duke mos precizuar asnjë vendvotim dhe të njëjtat janë vetëm pretendime dhe nuk argumentohen me asnjë prove.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.772/2021 më datën 05.11.2021

Kryesues i Panelit
Ferik Xhaferi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes pranimit të këtij vendimi.